



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

**Prokurorja e Specializuar k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe
Haxhi Shalës**

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 27 gusht 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën për Veçim

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit

Xhonatan Elistan Ris

Administratores

Fidelma Donlon

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit

Felisiti Geri

Mbrojtjes së Haxhi Shalës

Tobi Kadman

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 21(4)(d) dhe 39(9) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 9(5)(b) dhe 89(2)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara (“Rregullorja”), merr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCECDURAL

1. Më 2 tetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit (“z. Januzi”, “z. Bahtijari” dhe së bashku “të bashkakuzuarit”) (“Vendimi për Konfirmimin në Çështjen 10”).² Më 4 tetor 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi aktakuzën kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari, të konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake (“Aktakuza e Konfirmuar në Çështjen 10”).³

2. Më 4 dhjetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Haxhi Shalës (“z. Shala”) (së bashku me të bashkakuzuarit, “të akuzuarit”) (“Vendimi për Konfirmimin në Çështjen 11”).⁴ Më 6 dhjetor 2023, ZPS dorëzoi aktakuzën kundër z. Shala, të konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake (“Aktakuza e Konfirmuar në Çështjen 11”).⁵

¹ KSC-BC-2023-10, F00327, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatës së Procedurës Paraprake*, 6 qershor 2024, publik.

² KSC-BC-2023-10, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 2 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u dorëzuan më 12 tetor 2023, F00008/CONF/RED dhe F00008/RED. Versioni i korrigjuar i versionit të redaktuar publik të vendimit u dorëzua më 12 tetor 2023, F00008/RED/COR.

³ KSC-BC-2023-10, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrimi i Aktakuzës së Konfirmuar*, 4 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (riklasifikuar si publike më 21 mars 2024), me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Shtojcës u dorëzua më 6 tetor 2023, F00016 dhe F00016/A01.

⁴ KSC-BC-2023-11, F00005, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 4 dhjetor 2023, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 janar 2024, F00005/RED.

⁵ KSC-BC-2023-11, F00007, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrimi i Aktakuzës së Konfirmuar*, 6 dhjetor 2023, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale. Versionet e redaktuara publike të parashtrimit dhe Shtojcës u dorëzuan më 12 dhjetor 2023, F00013 dhe F00013/A01.

3. Më 8 shkurt 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim me të cilin (i) miratoi kërkesën e ZPS-së për bashkim të çështjes kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari ("Çështja 10") me çështjen kundër z. Shala ("Çështja 11") dhe (ii) i dha leje ZPS-së për të ndryshuar Aktakuzën e Konfirmuar në Çështjen 10 ("Vendimi për Bashkimin").⁶
4. Më 16 shkurt 2024, në bazë të Vendimit për Bashkimin,⁷ ZPS dorëzoi një version të ndryshuar të Aktakuzës së Konfirmuar në Çështjen 10 ("Aktakuza e Konfirmuar e Rishikuar në Çështjen 10").⁸
5. Më 17 maj 2024, me kërkesë të ZPS-së,⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake (i) i dha leje ZPS-së të ndryshonte Aktakuzën e Konfirmuar të Rishikuar në Çështjen 10 në lidhje me pretendime faktike të reja mbi të cilat mbështetet akuza për frikësim në lidhje me z. Januzi dhe z. Bahtijari, si edhe Përmbledhjen përkatëse sipas rregullës 86(3)(b); dhe (ii) urdhëroi palët të dorëzonin përgjigje dhe kundërpërgjigje, sipas rastit, mbi pikën nëse materiali mbështetës për pretendimet e reja faktike e mbështet konstatimin për ekzistencën e dyshimit të bazuar mirë në bazë të rregullës 86(4) të Rregullores.¹⁰

⁶ KSC-BC-2023-10, F00161, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Bashkimin e Çështjeve dhe Ndryshimin e Aktakuzës*, 8 shkurt 2024, konfidencial; versioni i redaktuar publik i vendimit u dorëzua më të njëjtën ditë, F00161/RED; KSC-BC-2023-11, F00041, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Bashkimin e Çështjeve dhe Ndryshimin e Aktakuzës*, 8 shkurt 2024, konfidencial; versioni i redaktuar publik i vendimit u dorëzua më të njëjtën ditë, F00041/RED.

⁷ Vendimi për Bashkimin, para. 58(d).

⁸ KSC-BC-2023-10, F00176, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar*, 16 shkurt 2024, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, publik.

⁹ KSC-BC-2023-10, F00189, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)*, 27 shkurt 2024, publike, me Shtojcat 1-2, konfidenciale. *Shih edhe* Vendimin për Bashkimin, para. 55, 58(e).

¹⁰ KSC-BC-2023-10, F00294, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Aktakuzës*, 17 maj 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik i vendimit u dorëzua më 9 korrik 2024, F00294/RED.

6. Më 8 korrik 2024, pasi mori parashtrime, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ndryshoi akuzën e frikësimit kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari ("Vendimi për Konfirmimin e Aktakuzës").¹¹
7. Më 10 korrik 2024, ZPS dorëzoi aktakuzën e ndryshuar, sipas konfirmimit ("Aktakuza e Ndryshuar").¹²
8. Më 19 korrik 2024, Mbrojtja e z. Shala ("Mbrojtja e Shalës") dorëzoi një kërkesë me të cilën kërkonte që akuzat kundër z. Shala të veçoheshin nga akuzat kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari dhe që z. Shala të gjykohej veçmas nga z. Januzi dhe z. Bahtijari ("Kërkesa").¹³
9. Më 24 korrik 2024, Mbrojtja e Shalës dorëzoi një shtesë të Kërkesës ("Parashtrimi Shtesë").¹⁴
10. Më 31 korrik 2024, ZPS iu përgjigj Kërkesës ("Përgjigja").¹⁵
11. Më 6 gusht 2024, Mbrojtja e Shalës iu kundërpërgjigj Përgjigjes ("Kundërpërgjigja").¹⁶
12. Më 7 gusht 2024, Mbrojtja e Shalës kërkoi që Kundërpërgjigja të konsiderohej si e vlefshme ("Kërkesa në Lidhje me Kundërpërgjigjen").¹⁷

¹¹ KSC-BC-2023-10, F00377, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve të Aktakuzës dhe Çështje të Lidhura me Të*, 8 korrik 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik i vendimit u dorëzua më 9 korrik 2024, F00377/RED. Në vendim, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ndryshoi edhe afatet për dorëzimin e çdo mocioni paraprak nga z. Januzi dhe z. Bahtijari, *shih* Vendimin për Konfirmimin e Aktakuzës, para. 78, 79(g).

¹² KSC-BC-2023-10, F00379, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrimi prej Prokurorisë të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar*, 10 korrik 2024, publik, me Shtojcat 1-2, konfidenciale, dhe Shtojcat 3-4, publike.

¹³ KSC-BC-2023-10, F00403, Mbrojtja e Shalës, *Kërkesë e Haxhi Shalës për Veçim*, 19 korrik 2024, publike.

¹⁴ KSC-BC-2023-10, F00407, Mbrojtja e Shalës, *Parashtrim Shtesë ndaj Kërkesës së Haxhi Shalës për Veçim*, 24 korrik 2024, publike.

¹⁵ KSC-BC-2023-10, F00416, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Haxhi Shalës për Veçim*, 31 korrik 2024, publike.

¹⁶ KSC-BC-2023-10, F00427, Mbrojtja e Shalës, *Kundërpërgjigje ndaj Parashtrimit F00416*, datë 5 gusht 2024 por njoftuar më 6 gusht 2024, publike.

¹⁷ KSC-BC-2023-10, F00428, Mbrojtja e Shalës, *Parashtrim në lidhje me Kundërpërgjigjen ndaj Parashtrimit F00416*, 7 gusht 2024, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

13. Më 12 gusht 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi një vendim mbi mocionet paraprake ("Vendimi mbi Mocionet Paraprake").¹⁸

II. PARASHTRIMET

A. KËRKESA

14. Mbrojtja e Shalës parashtrohet se z. Shala përballet me vonesa të tjera të panevojshme në kalimin e çështjes së tij Trupit Gjykues ndërkohë që pret rezultatin e mocioneve paraprake sipas rregullës 97 të Rregullores të cilat nuk kanë të bëjnë me të dhe të cilat mund të duan disa javë, në mos muaj.¹⁹ Mbrojtja e Shalës pretendon se, për pasojë, në qoftë se z. Shala do të vijojë ta ketë çështjen të bashkuar me z. Januzi dhe z. Bahtijari, do të shkelet e drejta e z. Shala për gjykim brenda një afati të arsyeshëm sipas nenit 31(2) të Kushtetutës, nenit 6(1) të Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("KEDNJ") dhe nenit 21(4(d)) të Ligjit.²⁰

15. Mbrojtja e Shalës argumenton se z. Shala është cenuar nga vonesa të njëpasnjëshme në këtë çështje gjyqësore deri tani, përfshirë edhe si pasojë e shtimit të një akuze kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari.²¹

16. Mbrojtja e Shalës parashtrohet gjithashtu se, ndërkohë që ajo vetë është gati për gjykim, mbetet e paqartë se kur do të jetë gati për gjykim çështja gjyqësore. Ajo argumenton se është thjesht e palejueshme të vijohet të mbahet në paraburgim z.

¹⁸ KSC-BC-2023-10, F0433, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet Paraprake dhe Kërkesat Lidhur me To*, 12 gusht 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F0433/RED.

¹⁹ Kërkesa, para. 14-15. *Shih edhe* Kërkesën, para. 22.

²⁰ Kërkesa, para. 16.

²¹ Kërkesa, para. 15-17, 19.

Shala për vonesa të vazhdueshme për të cilat ai nuk ka asnjë përgjegjësi dhe të cilat janë jashtë kontrollit të tij.²²

17. Mbrojtja e Shalës përfundon se Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhet ta veçojë çështjen e tij nga çështja e z. Januzi dhe z. Bahtijari në mënyrë që çështja kundër z. Shala të mund të kalohet më shpejt për gjykim.²³

B. PARASHTRIMI SHITESË

18. Mbrojtja e Shalës parashtro se, pas dorëzimit të mocioneve paraprake nga z. Januzi dhe z. Bahtijari, sipas rregullës 97 të Rregullores, dhe duke mbajtur parasysh vendimin e Gjykatës së Procedurës Paraprake mbi kalendarin për kalimin e çështjes gjyqësore Trupit Gjykues, çdo apelimi i vendimit a vendimeve mbi mocionet në fjalë mund ta zgjatë fazën e procedurës paraprake me një kohë të konsiderueshme.²⁴

C. PËRGJIGJJA

19. ZPS-ja parashtro se veçimi i çështjeve nuk do ta përshpejtojë procesin kundër z. Shala dhe do të vononte pashmangshmërisht njërin prej dy gjykimeve të veçuara, duke vënë kështu në rrezik të drejtat e të bashkakuzuarve të z. Shala. ZPS-ja parashtro më tej se arsyet bindëse që e shtynë Gjykatësin e Procedurës Paraprake të bashkonte aktakuzat mbeten të vlefshme dhe janë argumente tërësisht kundër veçimit të tyre.²⁵

²² Kërkesa, para. 19-20.

²³ Kërkesa, para. 1, 13, 21, 23.

²⁴ Parashtrimi Shtesë, para. 5-6, 8-11 ku i referohet KSC-BC-2023-10, F00406, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesa të Ndryshme të Mbrojtjes* ("Vendimi i 23 Korrikut 2024"), 23 korrik 2024, publik.

²⁵ Përgjigjja, para. 1, 2, 12.

20. Më konkretisht, ZPS parashtron se, sipas Gjykatës së Apelit, e drejta për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme sipas nenit 21(4)(d) të Ligjit i mbron të akuzuarit nga vonesat e papërligjura, por jo nga të gjitha vonesat e procesit.²⁶

21. ZPS-ja parashtron edhe se, sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ"), gjatë bërjes së konstatimit nëse procesi penal ka qenë në përgjithësi i arsyeshëm, ndër faktorët relevantë që duhen mbajtur parasysh përfshihen: (i) sjellja e paditësit dhe sjellja e autoriteteve përkatëse; (ii) kompleksiteti i çështjes; dhe (iii) çfarë është në pyetje për paditësin. ZPS-ja parashtron se, në qoftë se zbatohen këto kritere, kohëzgjatja e procesit aktual është qartësisht e arsyeshme.²⁷

22. ZPS-ja përfundon se Kërkesa duhet refuzuar.²⁸

D. KUNDËRPËRGJIGJJA

23. Mbrojtja e Shalës kundërpërgjigjet se z. Shala vuan dhe do të vijojë të vuajë vonesë të *papërligjur* në qoftë se nuk veçohen çështjet gjyqësore.²⁹

24. Mbrojtja e Shalës parashtron se, në qoftë se nuk gjykohet veçmas nga të bashkakuzuarit, zotit Shala do t'i duhet të presë për vendimet në procedurat në lidhje me mocionet paraprake të të bashkakuzuarve – përpara se të dalë në gjyq.³⁰ Sipas Mbrojtjes së Shalës, procedurat në fjalë, që nuk kanë të bëjnë me z. Shala, janë e vetmja arsye që pengojnë fillimin e gjykimit të z. Shala dhe, sipas saj, kjo përbën vonesë të *papërligjur*.³¹ Mbrojtja e Shalës parashtron se, në kundërshtim me parashtrimin e ZPS-së, veçimi nuk do t'i dëmtonte të bashkakuzuarit, meqë çdo

²⁶ Përgjigjja, para. 3.

²⁷ Përgjigjja, para. 3, 13.

²⁸ Kërkesa, para. 1, 14.

²⁹ Kundërpërgjigjja, para. 8-11, 17.

³⁰ Kundërpërgjigjja, para. 9, 16. *Shih* Kërkesën, para. 15-16.

³¹ Kundërpërgjigjja, para. 11.

vonesë e mundshme për të bashkakuzuarit do të rridhte nga procedurat lidhur me mocionet paraprake të tyre dhe, rrjedhimisht, nuk do të ishte *e papërligjur*.³²

25. Mbrojtja e Shalës parashtron gjithashtu se, meqë ZPS-ja do të thërrasë vetëm dy dëshmitarë, ndikimi i veçimit të gjykimeve në kapacitetin e përgjithshëm të Dhomave të Specializuara ("DHS") do të jetë minimal.³³ Mbrojtja e Shalës parashtron edhe se, megjithëse veçimi i gjykimeve mund të ketë disavantazhe për personat në çështje gjyqësore ku gjykohen të njëjtat fakte, e drejta themelore e z. Shala për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ka epërsi dhe duhen marrë masa për të mundësuar gjykime të veçuara.³⁴

26. Së fundi, Mbrojtja e Shalës shprehet se është i pasaktë parashtrimi i ZPS-së se arsyet bindëse që çuan në bashkimin e Çështjes 10 me Çështjen 11 mbeten të vlefshme dhe e bëjnë tërësisht të pamundur veçimin e çështjeve, sepse në kohën e Vendimit për Bashkimin nuk kishte pasur zgjatje të fazës së procedurës paraprake për shkak të rishikimeve të aktakuzës që kishin të bënin vetëm me të bashkakuzuarit.³⁵

27. Për këto arsye, Mbrojtja e Shalës përsërit kërkesën e saj që Gjykatësja e Procedurës Paraprake ta veçojë çështjen kundër z. Shala nga çështja kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari, në mënyrë që çështja e z. Shala të kalojë më shpejt në gjykim.³⁶

E. KËRKESA NË LIDHJE ME KUNDËRPËRGJIGJEN

³² Kundërpërgjigjja, para. 12-13, 16-17.

³³ Kundërpërgjigjja, para. 14.

³⁴ Kundërpërgjigjja, para. 18.

³⁵ Kundërpërgjigjja, para. 19-20.

³⁶ Kundërpërgjigjja, para. 24.

28. Mbrojtja e Shalës shprehet se, për arsye teknike jashtë kontrollit të saj, nuk arriti ta dorëzonte Kundërpërgjigjen më 5 gusht 2024. Rrjedhimisht, ajo kërkon që Kundërpërgjigjia të konsiderohet si e dorëzuar sipas rregullave.³⁷

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

29. Në bazë të nenit 39(9) të Ligjit, me kërkesë të palëve ose pas njoftimit të palëve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake (ose trupi gjykues nëse është i informuar) mund të udhëzojë bashkimin ose veçimin e çështjeve gjyqësore në lidhje me akuzat kundër më shumë se një të akuzuari.

30. Në bazë të nenit 21(4)(d) të Ligjit, në përcaktimin e akuzave kundër të akuzuarit sipas Ligjit, i akuzuari gëzon të drejtën të gjykohet brenda një kohe të arsyeshme.

31. Në bazë të rregullës 89(2)(b) të Rregullores, në cilëndo fazë të procesit, pasi dëgjon palët, një panel mund të urdhërojë që personat e akuzuar bashkërisht të gjykojnë veçazi për hir të një gjykimi të drejtë e të shpejtë, ose për të shmangur çfarëdo konflikti interesash që mund t'i shkaktojë padrejtësi të rëndë një të akuzuari.

32. Në bazë të rregullës 9(5)(b) të Rregullores, në qoftë se i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, paneli mund të njohë si të vlefshëm çfarëdo veprimi të ndërmarrë pas përfundimit të afatit përkatës.

IV. DISKUTIM

A. ASPEKTE PARAPRAKE

1. Parashtrimi Shtesë

³⁷ Kërkesa në Lidhje me Kundërpërgjigjen, para. 1-2.

33. Mbrojtja e Shalës kërkon që Gjykatësja e Procedurës Paraprake të marrë në konsideratë Parashtrimin Shtesë kur të marrë vendim për Kërkesën.³⁸ ZPS-ja përgjigjet se z. Shala duket se e ka dorëzuar Parashtrimin Shtesë pa leje, pa shpjeguar bazën ligjore dhe jashtë afatit të vendosur për dorëzimin e mocioneve sipas rregullës 97 të Rregullores.³⁹ Mbrojtja e Shalës kundërpërgjigjet se interpretimi i rregullës 76 të Rregullores në një mënyrë që përjashton parashtrime të tilla devijon nga praktika e DHS-së dhe se në Përgjigje nuk merret parasysh fakti që Mbrojtja e Shalës i shpjegoi arsyet e dorëzimit të Parashtrimit Shtesë dhe i kërkoi shprehimisht Gjykatësës së Procedurës Paraprake ta marrë atë parasysh në vendimin që do të merrte për Kërkesën.⁴⁰

34. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren fillimisht se, në dallim nga çfarë parashtron ZPS-ja, Mbrojtja e Shalës i kërkoi shprehimisht Gjykatësës së Procedurës Paraprake që ta merrte në konsideratë Parashtrimin Shtesë dhe dha arsyet për dorëzimin e tij.⁴¹ Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon gjithashtu se Parashtrimi Shtesë u dorëzua për të përfshirë konstatimet e bëra në Vendimin mbi Kërkesa të Ndryshme të Mbrojtjes (“Vendimi i 23 Korrikut 2024”), i cili u lëshua *pas* Kërkesës dhe përfshin afate të reja procedurale që janë relevante për marrjen e vendimit për Kërkesën. Gjykatësja e Procedurës Paraprake po kështu bindet se, duke pasur parasysh objektin e kufizuar të Parashtrimit Shtesë dhe faktin se ZPS-ja pati mundësi të komentonte për të në Përgjigjen e saj, ajo nuk i shkakton dëm ZPS-së. Rrjedhimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vendos që ta marrë në konsideratë Parashtrimin Shtesë në këtë vendim.

2. Kundërpërgjigjja

³⁸ Parashtrimi Shtesë, para. 1, 12.

³⁹ Përgjigjja, poshtëshënimi 1.

⁴⁰ Kundërpërgjigjja, para. 22 ku i referohet Parashtrimit Shtesë, para. 12.

⁴¹ *Shih* Parashtrimin Shtesë, para. 12.

35. Mbrojtja e Shalës parashtroi se data dhe ora e dorëzimit të Kundërpërgjigjes është 6 gusht 2024, ora 17:31, si në vetë parashtrimi, ashtu edhe në sistemin *Legal Workflow*. Megjithatë, Mbrojtja e Shalës parashtroi se u përpoq ta dorëzonte Kundërpërgjigjen më 5 gusht 2024 por nuk mundi, për arsye teknike jashtë kontrollit të saj. Për këtë arsye, Mbrojtja e Shalës kërkon që Kundërpërgjigjja të konsiderohet si e dorëzuar në mënyrë të vlefshme brenda afatit.⁴²

36. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se, më 5 gusht 2024, në orën 23:31, Mbrojtja e Shalës informoi Njësinë e Administrimit të Gjykatës ("NJAGJ") se po haste probleme të lidhesh me sistemin, duke i bashkëlidhur mesazhit parashtkrimin në fjalë dhe se, më 6 gusht 2024, pas zgjidhjes së problemeve teknike të lartpërmendura, Mbrojtja e Shalës e dorëzoi Kundërpërgjigjen për protokollim, sipas kërkesës së NJAGJ-së.⁴³ Për rrjedhojë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se Mbrojtja e Shalës ka treguar arsye të vlefshme dhe, rrjedhimisht, e njeh Kundërpërgjigjen si të dorëzuar në mënyrë të vlefshme në bazë të rregullës 9(5)(b) të Rregullores.

B. THEMELËSIA

37. Kërkesa bazohet në argumentin se, në qoftë se çështja kundër z. Shala dhe të bashkakuzuarve qëndron e bashkuar, z. Shala do të përballlet me vonesa (të mëtejshme) të papërligjura, në shkelje të së drejtës së tij për gjykim brenda një kohe të arsyeshme siç përcaktohet në nenin 6(1) të KEDNJ-së dhe në nenin 21(4)(d) të Ligjit.⁴⁴

38. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se, në bazë të nenit 39(9) të Ligjit dhe rregullës 89(2) të Rregullores, ajo ka kompetencën diskreacionale të urdhërojë që personat e akuzuar bashkërisht të gjykojnë veças.⁴⁵ Sipas alternativës së parë në

⁴² Kërkesa në Lidhje me Kundërpërgjigjen, para. 2.

⁴³ Shtojca 1 e Kërkesës në Lidhje me Kundërpërgjigjen.

⁴⁴ *Shih më lart* para. 14-15, 18, 23-27.

⁴⁵ *Shih* Vendimin për Bashkimin, para. 25.

rregullën 89(2)(b) të Rregullores, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mund të urdhërojë që të akuzuarit, për të cilët është paraqitur aktakuzë e përbashkët, të gjykohen veças, për hir të një gjykimi të shpejtë e të drejtë. Pra, ky vendim ka si bazë ligjore rregullën 89(2)(b) të Rregullores.

39. Në bazë të alternativës së parë të rregullës 89(2)(b) të Rregullores, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka për detyrë të vlerësojë nëse gjykimi veçmas i z. Shala është në favor të një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë. Z. Shala ngre shqetësimin e “vonesës së papërligjur”. Për këtë arsye, Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të vlerësojë nëse shkelet e drejta e z. Shala për t’u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme, në qoftë se gjykimi bëhet bashkërisht me të bashkakuzuarit, parë nga kriteri “për hir të një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë” sipas rregullës 89(2)(b) të Rregullores.

40. Ashtu si në rastin e bashkimit të akuzave kundër disa të akuzuarve, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerëson se gjatë ushtrimit të kompetencës së saj diskrecionale për ta veçuar një çështje, ajo duhet të vendosë balancë të drejtë mes nevojës për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë dhe respektimin e të drejtave të akuzuarve për gjykim të drejtë dhe të shpejtë.⁴⁶ Gjykatësja e Procedurës Paraprake nënvizon edhe se, duke pasur parasysh se kjo çështje gjyqësore ka tre të akuzuar, të drejtat e z. Shala duhen analizuar duke mbajtur parasysh të njëjtat të drejta të të bashkakuzuarve të tij.⁴⁷

⁴⁶ *Shih* Vendimin për Bashkimin, para. 25 dhe referencat në të. *Shih edhe* GJEDNJ, *Wejrup v. Denmark* (“*Wejrup v. Denmark*”), no. 49126/99, Admissibility Decision, 7 March 2002, f. 10-11.

⁴⁷ Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton, për shembull, se ndikimi i bashkimit të Çështjes 10 me Çështjen 11 në të drejtat e të bashkakuzuarve për t’u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme në bazë të nenit 21(4)(d) të Ligjit është marrë në konsideratë gjatë miratimit të kërkesës së ZPS-së për bashkimin e çështjeve në fjalë (*Shih* Vendimin për Bashkimin, para. 32-33). *Shih ngjashëm* ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Kunarac and Kovać*, IT-96-23-PT, Trial Chamber II, *Decision on Joinder of Trials*, 9 February 2000, para. 11; ICC/GJPN, *Prosecutor v. Ruto et al.*, ICC-01/09-01/11-221, Pre-Trial Chamber II, *Order to the Defence to Reduce the Number of Witnesses to Be Called to Testify at the Confirmation of Charges Hearing and to Submit an Amended List of Viva Voce Witnesses*, 25 July 2011, para. 13; *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo*, ICC-

1. Vlerësimi i kohës së arsyeshme

41. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se, siç është vendosur në jurisprudencën e GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit shihet në kontekstin e rrethanave të çështjes, çka kërkon një vlerësim të përgjithshëm, duke i kushtuar vëmendje: (i) kompleksitetit të çështjes; (ii) sjelljes së paditësit dhe sjelljes së autoriteteve përkatëse administrative dhe gjyqësore; dhe (iii) çfarë është në pyetje për paditësin në atë mosmarrëveshje.⁴⁸ Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se e drejta për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme në bazë të nenit 21(4)(d) të Ligjit i mbrojtur të akuzuarit nga vonesa e papërligjur dhe jo nga një vonesë e përligjur apo e nevojshme në proces.⁴⁹

(a) Kompleksiteti i çështjes

42. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se kjo çështje gjyqësore ka tre të akuzuar kundër të cilëve janë ngritur dy akuza për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe një akuzë për frikësim gjatë procedurës penale, sipas formave alternative të sjelljes, dhe sipas formave të ndryshme të përgjegjësisë penale, në lidhje me sjellje që filluan të kryhen në prill 2023. Rikujtojmë gjithashtu se për këto akuza, të akuzuarit mund të dënohen, përkatësisht, deri në pesë dhe dhjetë vjet burgim.⁵⁰ Gjykatësja e Procedurës

01/04-01/07-2259, Appeals Chamber, *Judgment on the Appeal of Mr Katanga Against the Decision of Trial Chamber II on 20 November 2009 Entitled "Decision on the Motion of the Defence for Germain Katanga for a Declaration on Unlawful Detention and Stay of Proceedings,"*, 12 July 2010, para. 82-84.

⁴⁸ GJEDNJ, *Salapa v. Poland* ("Salapa v. Poland"), no. 35489/97, Judgment, 19 March 2003, para. 83-89; *Wejrup v. Denmark*, f. 9-12; *Boddaert v. Belgium*, no. 12919/87, Judgment, 12 October 1992, para. 36; *Chiarello v. Germany*, no. 497/17, Judgment, 4 November 2019, para. 45; *Liblik and Others v. Estonia*, nos. 173/15, Judgment, 7 October 2019, para. 91. *Shih edhe* KSC-BC-2018-01, IA001/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelimin e Vendimit mbi Kërkesën për Urdhër Drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër Driton Lajçit*, 1 tetor 2021, publik, para. 22.

⁴⁹ KSC-BC-2020-06, IA028/F00011/RED, Gjykata e Apelit, *Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit kundër Vendimit Gojor mbi Marrjen në Pyetje nga Trupi Gjyqësor*, 4 korrik 2023, publik, para. 51.

⁵⁰ *Shih* Aktakuzën e Ndryshuar; *Vendimi për Konfirmimin në Çështjen 10*, para. 26, 36-37; *Vendimi për Konfirmimin në Çështjen 11*, para. 26, 36-37.

Paraprake vëren edhe se provat në këtë çështje përfshijnë dëshmi gojore të dëshmitarëve në gjykim dhe prova dokumentare, ndër të cilat komunikimet elektronike të të akuzuarve të nxjerra me ekspertizë kriminalistike nga telefona celularë.⁵¹ Në lidhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se nevoja për të analizuar komunikimet elektronike e rrit kompleksitetin e hetimit. Duke mbajtur parasysh këta faktorë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake është e mendimit se kjo çështje gjyqësore është relativisht komplekse.

(b) Sjellja e autoriteteve përkatëse

43. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se: (i) pas Vendimit për Konfirmimin në Çështjen 10, z. Januzi dhe z. Bahtijari u arrestuan⁵² dhe u transferuan me shpejtësi në objektin e paraburgimit të DHS-së, përkatësisht më 5 dhe 6 tetor 2023;⁵³ dhe (ii) pas Vendimit për Konfirmimin në Çështjen 11, z. Shala u arrestua më 11 dhjetor 2023 dhe u transferua me shpejtësi në objektin e paraburgimit të DHS-së më 12 dhjetor 2023.⁵⁴ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se ZPS-ja kërkoi bashkimin e Çështjes 10 me Çështjen 11 më 13 dhjetor 2023, pra pak kohë pas arrestimit dhe transferimit të z. Shala dhe se kërkesa në fjalë u miratua më 8 shkurt 2024.⁵⁵

⁵¹ Përgjigjja, para. 10. *Shih* KSC-BC-2023-10, F00374, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim nga Prokuroria i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale*, 5 korrik 2024, konfidencial, me Shtojcën 1 (“Lista e Ndryshuar e Provave Materiale”), konfidencial.

⁵² KSC-BC-2023-10, F00011, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Ismet Bahtijarit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, publik; F00012, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Sabit Januzit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, publik.

⁵³ KSC-BC-2023-10, F00014, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Ismet Bahtijarit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 tetor 2023, publik me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; versioni i redaktuar publik i Shtojcës 1 u dorëzua më 13 nëntor 2023, *shih* F00101/A01. F00015, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Sabit Januzit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 tetor 2023, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; versioni i redaktuar publik i Shtojcës 1 u dorëzua më 13 nëntor 2023, *shih* F00101/A02.

⁵⁴ KSC-BC-2023-11, F00008, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Haxhi Shalës sipas Rregullës 55(4)*, 11 dhjetor 2023, publik; F00011, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Haxhi Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 12 dhjetor 2023, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i Shtojcës 1 u dorëzua më 15 dhjetor 2023, *shih* F00021/A01.

⁵⁵ Vendimi për Bashkimin, para. 58(a).

44. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren gjithashtu se zbulimi i pretendimeve të reja faktike dhe provave të lidhura me ngjarjet e parashtruara në Aktakuzën e Konfirmuar në Çështjen 10, pas Vendimit për Konfirmimin në Çështjen 10, u bënë shkas për veprimtari të tjera hetimore⁵⁶ dhe çoi në procesin e ndryshimit të Aktakuzës.⁵⁷ Sikurse është konstatuar më parë, sipas mendimit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake, ZPS veproi me zellin e duhur për të kërkuar ndryshimin e Aktakuzës së Konfirmuar në Çështjen 10.⁵⁸

45. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren gjithashtu se: (i) për shkak të bashkimit të Çështjes 10 me Çështjen 11 më 8 shkurt 2024, u vendosën afate të reja për të harmonizuar afatet mes dy çështjeve, për të pakësuar vonesat dhe për të dhënë kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes;⁵⁹ dhe (ii) përgatitjet për kalimin e çështjes gjyqësore Trupit Gjykues vazhduan të përparojnë. Në veçanti, (i) ZPS-ja i ka kryer detyrimet e veta të fazës paraprake (nxjerrjen e materialeve) brenda afateve të vendosura nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake;⁶⁰ (ii) palët kanë dorëzuar pikat juridike dhe faktike për të cilat pajtohen, në një parashtrim të protokolluar të përbashkët;⁶¹ (iii) ZPS-ja ka dorëzuar dosjen paraprake;⁶² dhe

⁵⁶ *Shih, për shembull, KSC-BC-2023-10, F00103/RED, Prokurorja e Specializuar, Version i Redaktuar Publik i Kërkesës së Prokurorisë për Urdhër dhe [REDAKTUAR] me një Shtojcë Rreptësisht Konfidenciale dhe Ex Parte, 15 nëntor 2024, publik.*

⁵⁷ *Shih Vendimin për Konfirmimin e Aktakuzës, para. 5-11.*

⁵⁸ *Shih Vendimin për Bashkimin, para. 44.*

⁵⁹ *Shih Vendimin për Bashkimin, para. 33.*

⁶⁰ *Shih KSC-BC-2023-10, F00233, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim që Përcakton Kalendarin për Hapat e Mbetur Proceduralë të Fazës së Procedurës Paraprake ("Vendimi mbi Kalendarin"), 27 mars 2024, publik, para. 23, 25, 30(e), (g); F00260, Prokurorja e Specializuar, Njoftim i Hollësishëm i Prokurorisë në lidhje me Procesin e Nxjerrjes së Materialeve, 19 prill 2024, publik; F00352, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, Vendim mbi Kërkesat e Prokurorisë për Nxjerrje të Materialeve sipas Rregullës 102(1)(b) dhe për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale, 28 qershor 2024, konfidencial; Lista e Ndryshuar e Provave Materiale.*

⁶¹ *KSC-BC-2023-10, F00296, Prokurorja e Specializuar, Njoftim për Faktet dhe Pikat Juridike për të Cilat ka Pajtim, 17 maj 2024, publik, me Shtojcat 1-2, konfidenciale.*

⁶² *KSC-BC-2023-10, F00177, Prokurorja e Specializuar, Parashtrim i Dosjes Paraprake të Prokurorisë, Listës së Dëshmitarëve, Listës së Provave Materiale dhe Tabelës sipas Rregullës 109(c), 16 shkurt 2024, publik, me Shtojcat 1-4, konfidenciale; versioni i redaktuar publik i Shtojcës 1 u dorëzua më 3 korrik 2024, F00367/A01.*

(iv) ZPS-ja i ka përfunduar hetimet përpara kalimit të çështjes gjyqësore Trupit Gjykues.⁶³ Gjithashtu, konferencat për ecurinë e çështjes sipas rregullës 96(1) të Rregullores janë zhvilluar me intervale të rregullta për të siguruar që palët t'i përmbushin në mënyrë të shpejtë detyrimet që u takojnë në fazën e procedurës paraprake të kësaj çështjeje gjyqësore.⁶⁴

46. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton gjithashtu se data për kalimin e dosjes së çështjes gjyqësore Trupit Gjykues: (i) fillimisht ishte vendosur 21 qershori 2024 për shkak të kërkesave të ndryshme të ekipeve të Mbrojtjes të gjithë të akuzuarve për kohë shtesë për të zgjidhur probleme që kishin të bënin me financimin dhe me nxjerrjen e materialeve;⁶⁵ (ii) më pas u ndryshua dy herë me kërkesë të të bashkakuzuarve;⁶⁶ dhe (iii) u ndryshua më tej për të t'u dhënë të bashkakuzuarve kohë të mjaftueshme për dorëzimin e mocioneve paraprake pas daljes së Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës më 8 korrik 2024.⁶⁷

⁶³ Shih Vendimin mbi Kalendarin, para. 24, 30(f); KSC-BC-2023-10, F00249, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Përfundimin e Hetimeve*, 12 prill 2024, konfidenciale; version i redaktuar publik u dorëzua më 3 maj 2024, F00249/RED.

⁶⁴ Shih KSC-BC-2023-10, F00022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime*, 9 tetor 2023, publik; Transkript i seancës, 12 tetor 2023, publik, f. 33-71; F00081, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Dytë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime*, 27 tetor 2023, publik; Transkript i seancës, 3 nëntor 2023, publik, f. 72-92; F00121, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Tretë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime*, 8 dhjetor 2023, publik; Transkript i seancës, 14 dhjetor 2023, publik, f. 93-134; F00163, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime*, 8 shkurt 2024, publik; Transkript i seancës, 13 shkurt 2024, publik, f. 135-198; F00213, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime*, 14 mars 2024, publik; Transkript i seancës, 22 mars 2024, konfidencial; KSC-BC-2023-11, F00017, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime*, 13 dhjetor 2023, publik; Transkript i seancës, 15 dhjetor 2023, publik, f. 16-44.

⁶⁵ Shih Vendimin mbi Kalendarin, para. 14-17, 21(a), (d), (e), (g), 22, 29, 30(k).

⁶⁶ Shih KSC-BC-2023-10, F00324, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Bahtijarit për Zgjatje të Afatit*, 5 qershor 2024, publik; F00345, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Januzit për Zgjatje të Afatit*, 20 qershor 2024, publik.

⁶⁷ Shih Vendimin për Konfirmimin e Aktakuzës, para. 78, 79(g); KSC-BC-2023-10, F00382, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim Lidhur me Kalendarin e Çështjes Gjyqësore*, 12 korrik 2024, publik, para. 15, 16(a)-(d); Vendimi i 23 Korrikut 2024, para. 45.

47. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton në veçanti se, më 23 korrik 2024, caktoi kalendarin për pjesën e mbetur të fazës së procedurës paraprake dhe datën për kalimin e dosjes së çështjes Trupit Gjykues.⁶⁸ Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton edhe se mori vendim mbi mocionet paraprake përkatëse të z. Januzi dhe të z. Bahtijari më 12 gusht 2024.⁶⁹

48. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren, së fundi, se në kundërshtim me atë që parashtron Mbrojtja e Shalës,⁷⁰ kalimi i dosjes së çështjes Trupit Gjykues është vendosur të bëhet në të ardhmen e afërt, pas dhënies së vendimeve mbi mocionet paraprake, siç përcaktohet në Vendimin e 23 Korrikut 2024.⁷¹

49. Sipas mendimit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake, megjithëse është e vërtetë që procedura paraprake është ndikuar nga bashkimi çështjeve, procesi i ndryshimit të Aktakuzës dhe dorëzimi i mocioneve paraprake të të bashkakuzuarve, këta hapa proceduralë kanë rrjedhur nga zhvillimi i zakonshëm i procesit siç parashikohet në Ligj dhe në Rregullore. Çka është e rëndësishme, Mbrojtja e Shalës nuk ka provuar që procesi, e në veçanti hapat proceduralë të lartpërmendur janë kryer në mënyrë të papërshtatshme ose pa zellin e duhur.⁷²

⁶⁸ Vendimi i 23 Korrikut 2024, para. 37, 45, 50(b), (e). Në këtë kuadër, Gjykatësja e Procedurës Paraprake kishte marrë konkretisht në konsideratë se Mbrojtja e Shalës nuk kishte kundërshtim ndaj kërkesës së dytë të z. Januzi për zgjatje të afatit për dorëzimin e dosjes/dosjeve paraprake, nëse do të kishte, pas marrjes së një vendimi të formës së prerë mbi çdo mocion paraprak, *shih* Vendimin e 23 Korrikut 2024, para. 36.

⁶⁹ *Shih më lart* para. 13.

⁷⁰ *Shih më lart* para. 14, 18.

⁷¹ Në këtë kuadër, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se: (i) vetëm Mbrojtja e Januzit dorëzoi kërkesë për leje për të apeluar Vendimin mbi Mocionet Paraprake, e cila u rrëzua më 23 gusht 2024 si e dorëzuar jashtë afatit ("Vendimi i 23 gushtit 2024"), *shih* KSC-BC-2023-10, F00444, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim që Hedh Poshtë Kërkesën për Leje për Apelim të Vendimit F00433*, 23 gusht 2024, publik; (ii) afati për dorëzimin e një apeli të juridiksionit kundër Vendimit mbi Mocionet Paraprake përfundoi më 22 gusht 2024; dhe (iii) kërkesa e Mbrojtjes së Januzit për rishqyrtim të Vendimit të 23 gushtit 2024 u refuzua, *shih* F00451, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Rishikim të Vendimit F00444*, 27 gusht 2024, publik.

⁷² *Shih* GJEDNJ, *Wejrup v. Denmark*, p. 11; GJEDNJ, no. 13089/87, *Dobbertin v. France*, Judgment, 25 February 1993, para. 44. *Shih edhe më poshtë* para. 54-55.

(c) Sjellja e të akuzuarve

50. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren parashtrimet e Mbrojtjes së Shalës se (i) vazhdimisht është shprehur se z. Shala është gati për gjykim, (ii) vonesat në fillimin e gjykimit nuk janë shkaktuar prej tij dhe (iii) procesi i ndryshimit të Aktakuzës dhe procedurat vijuese të mocioneve paraprake nuk kanë të bëjnë me të.⁷³

51. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton fillimisht se data për kalimin e dosjes së çështjes gjyqësore Trupit Gjykues ishte caktuar fillimisht 21 qershori 2024 për shkak të kërkesave të ndryshme të ekipeve të Mbrojtjes, përfshirë Mbrojtjen e Shalës, për kohë shtesë për të zgjidhur aspekte të lidhura me financimin dhe me nxjerrjen e materialeve.⁷⁴

52. Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se, megjithëse procesi i ndryshimit kishte të bënte vetëm me Aktakuzën e Konfirmuar në Çështjen 10 (e përmendur si “Aktakuza e Konfirmuar e Rishikuar në Çështjen 10” pas Vendimit për Bashkimin), procesi në fjalë ishte në mënyrë të vetvetishme i lidhur me bashkimin e Çështjes 10 dhe Çështjes 11, për shkak se faktet për gjykim në të dy çështjet janë të njëjta, dhe çoi në konfirmimin e një aktakuze operative kundër të tre të akuzuarve, që është Aktakuza e Ndryshuar, në vend të dy aktakuzave të veçanta. Pra, sipas mendimit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake, në kundërshtim me atë që parashtron Mbrojtja e Shalës,⁷⁵ procesi i ndryshimit të Aktakuzës ka të bëjë edhe me z. Shala, ndonëse në mënyrë të tërthortë.

⁷³ *Shih më lart* para. 14-16; Kërkesa, para. 20.

⁷⁴ *Shih më lart* para. 46. *Shih për shembull* KSC-BC-2023-10, F00168, Mbrojtja e Shalës, *Parashtrime në Emër të Haxhi Shalës për Konferencën mbi Ecurinë e Çështjes*, 12 shkurt 2024, publike, para. 2(4)(a)(i), 2(6)(b); F00224, Mbrojtja e Shalës, *Parashtrime të Haxhi Shalës për Konferencën mbi Ecurinë e Çështjes më 22 mars 2024*, 19 mars 2024, publike, para. 2(4)(a)(iii), 2(6)(b).

⁷⁵ *Shih më lart* para. 15, 26.

53. Së fundi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake pajtohet me ZPS-në⁷⁶ se kohëzgjatja e procedurës paraprake si pasojë e dorëzimit të mocioneve paraprake të të bashkakuzuarve është e justifikuar dhe, rrjedhimisht, nuk ka “vonesë të papërligjur”, meqë, me paraqitjen e tyre, të bashkakuzuarit thjesht shfrytëzojnë plotësisht mjetet juridike që kanë në dispozicion për të mbrojtur interesat e tyre, siç parashikohet në Ligj dhe në Rregullore.⁷⁷ Sipas mendimit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake, nuk ka asnjë tregues që një ushtrim i tillë i të drejtave të synojë vonimin e procesit.⁷⁸ Madje, Mbrojtja e Shalës duket se pajtohet me këtë, sepse vazhdimisht shprehet se të bashkakuzuarit ushtrojnë të drejtën e tyre legjitime për dorëzimin e mocioneve paraprake, përfshirë apelimet e ndërmjetme që mund të paraqiten në të ardhmen.⁷⁹

(d) Çfarë është në pyetje për z. Shala

54. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se, megjithëse Mbrojtja e Shalës i kërkon të mbajë parasysh të drejtën e të akuzuarit për lirim në pritje të gjykimit, kur autoritetet përkatëse nuk kanë vepruar me zellin e duhur,⁸⁰ ajo nuk paraqiti prova në mbështetje të këtij pretendimi. Pavarësisht nga kjo mangësi në parashtrimin e Mbrojtjes së Shalës, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se në jurisprudencën e GJEDNJ-së, personat e mbajtur në paraburgim në pritje të gjykimit kanë të drejtën të presin që të ushtrohet “zell i veçantë” prej autoriteteve kompetente. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren në këtë kuadër se

⁷⁶ Përgjigjja, para. 7-8.

⁷⁷ *Shih më lart* para. 41.

⁷⁸ *Shih* ECtHR, *Wejrup v. Denmark*, p. 9; *Salapa v. Poland*, para. 86-89, *Eckle v. Germany*, no. 8130/78, Judgment, 15 July 1982, para. 82; *Sociedade de Construções Martins & Vieira, Lda., and Others v. Portugal*, nos. 56637/10, 59856/10, 72525/10, 7646/11 and 12592/11, Judgment, 30 January 2015, para. 48.

⁷⁹ Kërkesa, para. 19; F00392, Mbrojtja e Shalës, *Përgjigje ndaj Kërkesës së Januzit për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Dosjeve Paraprake të Mbrojtjes*, 16 korrik 2024, publike, para. 8.

⁸⁰ Kërkesa, para. 20.

kohëzgjatja e procesit mund të konsiderohet e paarsyeshme kur ka “periudha të zgjatura pasiviteti” si rezultat i mungesës së zellit.⁸¹

55. Në rastin konkret, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se, megjithëse procesi është ndikuar nga proceset e bashkimit të çështjes dhe ndryshimit të Aktakuzës, këto nuk përbëjnë “periudha të zgjatura pasiviteti” dhe, siç evidentohet më lart, ka pasur progres të vazhdueshëm në përgatitjen për kalimin e çështjes gjyqësore Trupit Gjykues.⁸² Pra, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk konstaton se ka pasur zgjatje të procedurës paraprake përtej asaj që është e arsyeshme për shkak të mungesës së zellit, që do të justifikonte lirimin në pritje të gjykit. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton edhe se, në bazë të nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, paraburgimi i z. Shala rishikohet çdo dy muaj ose sapo të ketë ndonjë ndryshim të rrethanave,⁸³ dhe, rrjedhimisht, Mbrojtja e Shalës ka mundësinë ta kundërshtojë arsyeshmërinë e mbajtjes në paraburgim të z. Shala nëpërmjet asaj procedure.

(e) Përfundim

56. Duke pasur parasysh të gjithë këta faktorë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është bindur se faza e tanishme e procesit është kryer me shpejtësi të pranueshme dhe se kohëzgjatja e përgjithshme e tij mbetet e arsyeshme.

2. Aspekte të administrimit të drejtësisë

57. Krahas sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerëson se e drejta e z. Shala për t’u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme duhet të balancohet me nevojën për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë. Në lidhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se argumentet që çuan në bashkimin

⁸¹ *Shih për shembull* GJEDNJ, *Abdoella v. Netherlands*, no. 12728/87, Judgment, 25 November 1992, para. 24.

⁸² *Shih më lart* para. 45-46.

⁸³ Rregulla 56(2) e Rregullores.

e Çështjes 10 me Çështjen 11 janë të vlefshme edhe sot. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton fillimisht se të akuzuarit akuzohen për të njëjtat vepra penale në lidhje me të njëjtat ngjarje.⁸⁴ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren edhe se gjykimet e veçuara do t'i dublonin provat.⁸⁵ Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se dëshmitarëve do t'u duhej të jepnin dëshmi në dy gjykime të veçanta, që do t'u shtonte vështirësitë dhe do t'i vinte në rrezik, për shkak të nevojës për të bërë më shumë se një udhëtim dhe për ta përsëritur dëshminë.⁸⁶ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren gjithashtu se veçimi i gjykimit do të rriste në mënyrë të pashmangshme përdorimin e kohës dhe burimeve gjyqësore.⁸⁷ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren në këtë aspekt se disponueshmëria e sallës së gjyqit të DHS-së është e kufizuar, sepse përdoret nga të gjithë trupat gjykues dhe panelet.⁸⁸ Për këto arsye, sipas mendimit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake, pavarësisht se sa parashikohet të zgjasë gjykimi, veçimi i çështjeve do të ndikonte në kapacitetet e DHS-së dhe me gjasë do ta vononte me muaj fillimin e njërit prej gjykimeve, duke rrezikuar kështu të drejtat e të akuzuarve për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme sipas nenit 21(4)(d) të Ligjit.⁸⁹

58. Sipas mendimit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake, faktorët e mësipërm janë argumente kundër veçimit të çështjeve.

3. Përfundim i përgjithshëm

59. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se Mbrojtja e Shalës nuk ka arritur të demonstrojë se veçimi është i nevojshëm në

⁸⁴ Vendimi për Bashkimin, para. 26-28.

⁸⁵ *Shih, ngjashëm*, Vendimin për Bashkimin, para. 30.

⁸⁶ *Shih, ngjashëm*, Vendimin për Bashkimin, para. 30.

⁸⁷ *Shih* Vendimin për Bashkimin, para. 30. Përgjigjja, para. 9.

⁸⁸ *Shih, për shembull*, KSC-BC-2020-04, F00591, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Paraqitjen e Listave të Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale (F00583)*, 14 korrik 2023, publik, para. 7.

⁸⁹ *Shih më lart* para. 41.

kushtet aktuale për hir të gjykimit të drejtë dhe të shpejtë dhe se ai i shërben administrimit të duhur të drejtësisë. Rrjedhimisht, Kërkesa rrëzohet.

V. VENDIM

60. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e **RRËZON** Kërkesën.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Marzhor Masëlo
Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E martë, 27 gusht 2024
Hagë, Holandë.